



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/33

Datë: 17.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# **KONCEPT-DOKUMENT**

---

## **PËR FUSHËN E THEMELIMIT TË FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE**

03 qershor 2015

## KONCEPT DOKUMENT

### PËR FUSHËN E THEMELIMIT TË FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

#### 1. HYRJE

Ky koncept-dokument është përgatitur në pajtim me Udhëzimin për Përgatitjen e Koncept-Dokumenteve dhe Memorandumeve Shpjeguese nr. 074/2012 të datës 19 mars 2012, si dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011.

Projektligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore nuk është pjesë e planit vjetor të punës, megjithatë duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik vlerësohet si një projekt me prioritet të lartë.

Mundësimi që NMVM-të të kenë qasje më të lehtë në financim është qenësore, duke marrë në konsideratë që sipas strategjisë për NMVM, një sfidë kritike për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë është gjetja e mënyrës së shfrytëzimit të likuditetit të bankave komerciale për të financuar rritjen e NMVM-ve dhe ndërmarrësve.

Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat poashtu thekson se pengesa kryesore për zhvillimin e NMVM-ve dhe krijimin e vendeve të punës është qasja joadekuate në financim, si dhe bizneset e prodhimit, punës së dorës, fermerët dhe shërbimet e ngjashme kanë vecanërisht probleme në marrjen e kredive që ju nevojiten.

Një arsye tjetër për prioritetin e lartë të Projektligjit për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore është fakti se donatorët ndërkombëtarë si USAID, KfW dhe SECO janë zotuar se do të japin mbi 20 milion dollarë amerikanë/18 milion Euro si asistencë teknike për të zhvilluar dhe implementuar Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) si dhe për të financuar kapitalin për të mbështetur garancitë.

Është esenciale që FKGK të themelohet sa më shpejtë që të jetë e mundur në mënyrë që të kapitalizohen fondet në fjalë dhe të arrihet një rritje ekonomike dhe punësim. Në

rast se themelimi i FKGK do të vonohej dhe nuk do të ndodhte brenda vitit 2015 fondet e donatorëve mund të mos jenë më në dizpozicion.

## 2. ÇËSHTJET KRYESORE QË ADRESOHEN

Qeveria e Kosovës, përkrahur nga Projekti i Fuqizimit të Mbështetjes së Kredive EMPOWER nga USAID, ka iniciuar hartimin e koncept dokumentit lidhur me themelimin e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive (“FKGK”) në një mënyrë të ngjashme me Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës. Themelimi i FKGK-së është në përputhje me «Strategjinë për Zhvillimin e NVM-ve të Kosovës 2012-2016» (Strategjia NVM) si dhe «Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017» (Strategjia për ZHSP).

Qëllimi i FKGK-së është të rritet qasja në financa për NMVM-të, bujqit, ndërmarrësit, bizneset e grave, si dhe bizneset e pakicave për të rritur prodhimin vendor, për të krijuar vende pune, për të përmirësuar bilancin tregtar, si dhe për të zgjeruar bazën tatimore të Kosovës si dhe sistemin pensional. Likuiditeti i tepërt në bankat e Kosovës shkon deri në 450 milionë euro, të cilat nuk janë duke u shfrytëzuar për të përkrahur rritjen e bizneseve dhe punësimin. FKGK-ja do të ndihmojë në çlirimin e atij likuiditeti, duke përshpejtuar kështu shumë rritjen ekonomike dhe zhvillimin e sektorit privat në Kosovë. Përveç kësaj, garancitë e FKGK-së do të mund të përdoren edhe nga institucionet mikro-financiare (IMF) dhe institucionet financiare jo-bankare (IFJB) për të zvogëluar riskun e tyre si dhe për të ndihmuar që bizneset e vogla të jenë më të qëndrueshme. ***Parashihet që FKGK-ja do të mund të mundësojë mbi 360 milionë euro në hua të reja, si dhe të krijojë mbi 20,000 vende të reja pune në 6 vitet e para të funksionimit të tij.***

Sipas Strategjisë për NVM-të, sfidë kritike për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë është që të gjendet një mënyrë për shfrytëzimin e likuiditetit të tepërt të bankave komerciale për të financuar rritjen e NMVM-ve dhe ndërmarrësve. Është gjithashtu e rëndësishme për IMF-të dhe NFJB-të që të ndihmojnë bizneset të rriten dhe të bëhen më të qëndrueshme në aspektin kreditor. Është ende tejet e vështirë për shumë NMVM, ndërmarrës, bujq, etj, që të sigurojnë shumat dhe llojet e financave që iu

duhen për kapitalin afatshkurtër punues por edhe investimet afatgjate. Pa zgjerimin e qasjes në financa, bizneset nuk mund të rriten, e as të eksportojnë, e as të punësojnë më shumë njerëz.

Strategjia për ZHSP gjithashtu thekson që një prej pengesave më kryesore ndaj zhvillimit të NMVM-ve dhe krijimit të vendeve të punës është qasja joadekuate në financa, derisa bizneset prodhuese, bujqësore, TIK-ut dhe ato shërbyese kanë vështirësi të posaçme në sigurimin e kredive që iu duhen. Përveç këtyre, shumë nga këto NMVM kanë pasuri të kufizuar të luajtshme e të paluajtshme si kolateral për kredi. Ky është problem edhe më i madh për bizneset me rritje të shpejtë, që kanë nevojë për kapital përditë e më shumë për të shtyrë përpara rritjen e tyre të përshpejtuar.

Strategjia për NMVM-të bën thirrje për zgjerimin e spektrit të instrumenteve financiare për NMVM-të, duke përfshirë edhe shfrytëzimin e skemave të garantimit të kredive, ndërsa Strategjia për ZHSP përcakton përmirësimin e vazhdueshëm të qasjes në financa si synim strategjik, për sigurimin e konkurrueshmërisë së NMVM-ve.

Raporti i Progresit nga Komisioni Evropian për Kosovën, i vitit 2014, gjithashtu thekson që qasja e kufizuar në financa është një prej sfidave kryesore të zhvillimit të NMVM-ve dhe rritjes së mëtutjeshme, ndërsa në Raportin e Bankës Botërore “Doing Business Report”, Kosova ka rënë tek indikatorin e marrjes së kredive nga vendi i 19-të më 2014 në të 23-tin në vitin 2015. Është e qartë që Kosova ka nevojë që urgjentisht të përmirësojë qasjen e NMVM-ve në financa.

## **2.1. Situata Ekzistuese e Kredive për NMVM**

Aktualisht në Kosovë, NMVM-të, fermerët, ndërmarrësit, inovatorët, bizneset e reja, bizneset në pronësi të grave si dhe bizneset në pronësi të minoriteteve kanë vështirësi të shumta për të pasur qasje në financimet që ju duhen për të rritur bizneset e tyre, për të krijuar prodhim lokal dhe shërbime me vlerë të shtuar, si dhe për të punësuar më shumë njerëz. Për shembull, edhe pse sektori i bujqësisë është një sektor madhor i ekonomisë me potencial të madh për rritje, eksportim dhe mundësi të reja punësimi, më pak se 5% e portfolios kreditore të bankave shkon për bujqësi. Për më tepër, më

pak se 2% e porfolios kreditore të bankave shkon për bizneset që janë pronë e grave. Aktualisht pothuajse nuk ka fare kreditim për bizneset në Veriun e Kosovës. Vlerësohet se hendeku aktual për financimin e NMVM-ve në Kosovë është mbi 500,000 milion Euro. Raporti i kredive me depozitat në Kosovë është vetëm 74.2%, që paraqet një indikacion se ndërmjetësimi financiar në Kosovë është i ulët dhe ka likuiditet tepriçë në dispozicion për të kredituar. Raporti i kredive me BPV në Kosovë është rreth 16%, një nga më të ulëtat në botë. Për qëllime krahasimi, Bosnja dhe Hercegovina e ka këtë raport mbi 30% kurse Kroacia mbi 35%. Në vendet Aziatike dhe ato të Amerikës Latine është mbi 60% dhe në vendet e zhvilluara mbi 120%.

## **2.2.Politikat e Ngjashme Ekzistuese**

Më 26 shtator, 2012, një marrëveshje për Autoritetin për Zhvillim Kreditor (AZHK) u nënshkruar në mes të USAID dhe gjashtë bankave lokale komerciale me financim të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). MBPZHR kontribuoi me 2.5 milion Euro bashkë me 26 milion dollarë kredi të planifikuara të gjeneroheshin përmes këtij programi.

Kredimarrësit e synuar ishin bizneset private që operojnë në Kosovë që merren me hortikulturë, bagëti dhe sektorët e drithrave. Kreditë kishin për synim investimet e grupeve të synuara për të inkurajuar rritjen ekonomike të kredimarrësve në sektorin e bujqësisë. Garancitë e portfolios së kredive të Autoritetit për Zhvillim Kreditor kishin për qëllim rritjen e qasjes në financim për sektorin e bujqësisë duke iu ofruar 50% garanci rreziku për kreditë e lëshuara nga bankat pjesëmarrëse. Garancitë e AZHK u dhanë bankave insentivë për ti financuar fermerët, për të demonstruar fitimin e tyre potencial. Në tabelën mëposhtë janë të pasqyruara në detaje periudhat, synimet dhe garancionet e dhëna nga AZHK te bankat komerciale.

Garancitë e ofruara nga AZHK po japin rezultate dhe po krijojnë shembuj të shumë të mirë. Megjithatë, ato tashmë kanë përfunduar edhe në aspektin kohor si dhe sa i përket fondeve, dhe tashmë ka nevojë më të madhe për të lehtësuar financimin e bujqësisë dhe NMVM-ve. FKGK, një fond lokal, i përhershëm, do të jetë në gjendje ta rijetësoj këtë shembull dhe ndjeshëm të rris qasjen në financa si dhe në baza të vazhdueshme dhe permanente.

**Tabela 1: Përvoja me Garancitë e AZHK**

Banka	Periudha	Synimet	Mbulesa me Garanci (mil \$)	Shfrytëzimi(%)
Raiffeisen	2006-13	Bujqësi	\$10	99.12%
Raiffeisen	2012-22	Bujqësi	\$7.2	51.12%
B.Ekonomike	2012-22	Bujqësi	\$1	17.95%
TEB	2011-18	Bujqësi	\$2.5	99.35%
TEB	2011-22	Bujqësi	\$5.7	43.22%
BKT	2012-22	Bujqësi	\$1	64.52%
NLB	2012-22	Bujqësi	\$1	93.98%
ProCredit	2012-22	Bujqësi	\$10	47.71%
Raiffeisen	2011-18	NVM < 3 vite	\$1	5.11%
B.Ekonomike	2011-18	NVM < 3 vite	\$1	2.32%

### 2.3. Përfshirja e Institucioneve Shtetërore dhe Palëve të Interesuara

Deri më tani procesi i konsultimit është bërë me të gjithë akterët relevantë, duke përfshirë, Zyrën e Presidentes, Zyrën e Kryeministrit, Zyrën e Kryetarit të Kuvendit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Integritimit Evropian, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Zyrën e Avokatit të Popullit.

Përveç institucioneve publike, poashtu janë konsultuar edhe grupet e tjera të interesit sic janë organizatat e biznesit, odat ekonomike dhe institucionet financiare, duke përfshirë bankat, institucionet financiare jo-bankare dhe institucionet mikro-financiare.

### 2.4. Korniza Ligjore Ekzistuese

Aktualisht nuk ka ndonjë akt ligjor apo nënligjor i cili do të ndikohej nga Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për garanci Kreditore, megjithatë në fazat e mëvonshme nëse është e nevojshme për qëllime të implementimit të këtij ligji, mund të nxjerren edhe akte nën-ligjore.

## **2.5. Përvojat nga Shtetet Tjera**

Në mënyrë që të vihet deri te rekomandimi për themelimin e një entiteti të pavarur juridik sic është Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, janë rishikuar Skemat e ngjashme për Garanci Kreditore (SKG) të adoptuara nga shtetet në rajon dhe ato të Bshkimit Evropian (BE), sic janë Sllovenia, Estonia, Portugalia dhe Rumania si dhe shtete të tjera nga Afrika, Lindja e Mesme dhe Azia . SKG të adoptuara nga këto shtete vëjnë në pah fleksibilitetin që kanë shtetet në dizajnimin dhe përshtatjen e këtyre skemave për të iu përshtatur nevojave të shtetit, marrë në konsideratë nivelin e progresit ekonomik karshi ekonomisë së tregut, kontekstin historik dhe popullsinë.

### Sllovenia

Në vitin 1992, Sllovenia adoptoi skemën e garancive të themeluar me ligj, të quajtur Fondi Slloven i Ndërmarrësisë (FSN). Në rast të dështimit garancia paguhet direkt nga buxheti i qeverisë, një praktikë e cila ka rritur aftësinë blerëse në sektorin bankar dhe financiar.

FSN poashtu bashkëpunon me bankat komerciale Sllovene, Fondin Evropian për Investime dhe Shoqatën Evropiane për Garanci Reciproke. FSN mbulon deri ne 80% të kredisë, dhe duke filluar nga 31 dhjetori 2012, FSN ka pasur 55.6 milion Euro kapital rezervë. FSN ka një Drejtor, si dhe Bord Mbikqyrës me shtatë anëtarë, i cili përbëhet nga katër anëtarë nga Qeveria, një anëtarë nga Oda Ekonomike dhe Industriale, një anëtarë nga Oda Zejtare dhe një anëtarë nga Shoqata e Bankave të Sllovenisë.

### Estonia



Fondi për Garanci Kreditore i Estonisë, KredEx, është një institucion i pavarur juridik i themeluar më 2001. Ngjashëm me FSN e Sllovenisë, ka një Drejtori Ekzekutiv dhe gjashtë anëtarë të Bordit Mbikqyrës, i cili përbëhet nga katër anëtarë nga Qeveria, një anëtarë nga Shoqatave e NVM të Estonisë dhe një anëtarë nga Shoqata e Estonisë për Energji të Ripërtitshme. KredEx poashtu ka një Departmant për Menaxhimin e Riskut me shtatë anëtarë ku së paku tre anëtarë janë juristë. Punon me sektorin e bankave dhe sektorin privat, si dhe me institucionet Evropiane Financiare.

### Rumania

Në Rumani, Fondi Rural për Garanci Kreditore ka strukturën e një shoqërie aksionare private, ku 99.97% të aksioneve janë pronë e tre bankave komerciale.

### Portugalia

Portugalia aplikon një Sistem të Garancisë së Përbashkët, i cili është një entitet juridik me autonomi financiare dhe administrative. Entiteti në fjalë në fillim kryesisht ka përfshirë institucionet publike dhe fondet për rritjen e qasjes në financa për NMVM. Që nga 2003, ky sistem ka filluar së operuari dhe është fokusuar kryesisht në bizneset e reja.

Në rastin e Kosovës, FKGK-ja do të ndihmojë në tejkalimin e pengesave për qasje në financa duke ofruar garanci kreditore për bankat, IMF-të dhe IFJB-të (institucionet financiare) për rastin e kredive për NMVM-të dhe grupet e sektorët tjerë më pak të favorizuar. Garancitë do të zvogëlojnë riskun e institucioneve financiare me deri në 50% të kryegjësë së kredisë, duke inkurajuar kështu më shumë kreditim nga institucionet financiare për NMVM-të. Institucionet financiare do të bëjnë vlerësimin vetanak dhe nënshkrimin e kredive për NMVM-të, ndërsa FKGK-ja do të sigurojë garancitë për institucionet financiare mbi këto kredi për një tarifë të caktuar. Këto tarifa do të ndihmojnë në vetëqëndrueshmërinë e FKGK-së.

Ky Koncept-Dokument thekson çështjet më të rëndësishme në lidhje me themelimin, rregullimin dhe operimin e FKGK-së. Disa çështje mund të kërkojnë përcaktim apo

hollësi të mëtutjeshme gjatë procesit konsultativ me palët përkatëse. Megjithatë, duhet mbajtur mend së pari interesi urgjent publik dhe nevoja ekonomike për themelimin e FKGK-së sa më shpejt që është e mundur.

## 2.6. Shpenzimet Ekzistuese

**Tabela 2: Shpenzimet Ekzistuese**

Kategoria e Shpenzimeve	Shpenzimet për vitin paraprak/2014	Buxheti për 2015	KASH për 2016
<b>Buxheti i MTI</b>			
- Paga dhe Mëditje	119,273.32	122,536.00	122,623.00
- Shpenzime Materiale	455,450.35	593,512.00	593,512.00
- Subvencione dhe Transfere	973,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00
- Shpenzimet Kapitale	525,222.27	780,000.00	830,000.00
<b>Bushet tjetër</b>	0.00	0.00	0.00
<b>Financime nga Donatorët</b>	0.00	0.00	0.00
<b>Shpenzime Direkte nga MF</b>	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>2,072,945.94</b>	<b>2,496,048.00</b>	<b>2,546,135.00</b>

**Shpalosje:** Në vitin 2015 janë të buxhetuara 1,000,000.00 euro nga MTI për Fondin e Garantimit të Kredive.

## 3. SYNIMET DHE NDËRLIDHJA ME PRIORITETET E QEVERISË

Qëllimi i përgjithshëm i Projektligjit për FKGK-në (Projektligji) është të ndihmojë në zgjidhjen e problemit të qasjes së kufizuar në financa, si pengesë për zhvillimin e NMVM-së, punësimin si dhe rritjen e përgjithshme ekonomike. Themelimi i FKGK-së drejtpërdrejt i shërben interesit publik dhe përkrah plotësisht Strategjinë për NMVM-të dhe Strategjinë për ZHSP.

Synimi specifik i projektligjit është të themelojë FKGK-në si fond lokal, i përhershëm, si dhe financiarisht i qëndrueshëm vendor, i cili lëshon garanci kreditore për institucionet financiare, ashtu që institucionet financiare të mund të rrisin në masë

dramatike kreditimin për NMVM-të dhe bizneset tjera më pak të shërbyera. FKGK-ja mundet që në të ardhmen të ofrojë edhe veprimtari të tjera të ndërmjetësimit financiar, në përputhje me mandatin e vet të rritjes së qasjes në financa në Kosovë, në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Mijëra biznese në Kosovë nuk arrijnë të sigurojnë financimin që iu duhet për t'u rritur, për të rritur shitjet, për t'u bërë më konkurrues, për të krijuar vende pune, për të eksportuar, apo për të zgjeruar prodhimtarinë vendore. Kjo është pengesë kritike ndaj rritjes ekonomike dhe punësimit në Kosovë, e cila duhet tejkaluar urgjentisht. FKGK-ja do të lehtësojë në masë të madhe rritjen e kreditimit nga institucionet financiare për bizneset vendore, duke ndihmuar kështu në tejkalimin e kësaj pengese. Rritja e kreditimit nga institucionet financiare do të çojë drejt rritjes së shitjeve, rritjes së punësimit, eksporteve, e zgjerimit të prodhimit vendor të produkteve cilësore e konkurruese, e përfundimisht edhe tek rritja e tatimeve në të ardhura dhe të ardhura pensionale. Veçanërisht, projektohet që FKGK-ja do të arrijë të mbështesë mbi 4,150 kredi të reja për NMVM-të me vlerë kumulative mbi 360 milionë euro, duke krijuar kështu mbi 20,000 vende të reja të punës në 6 vitet e para të funksionimit të tij.

Qeveria e Republikës së Kosovës si dhe donatorët ndërkombëtarë, si USAID, KfW dhe SECO janë zotuar tashmë për mbi 20 milionë dollarë/18 milionë euro në ndihmë teknike në zhvillimin dhe zbatimin e FKGK-së dhe kapitalit për dhënien e garancive. Është me rëndësi që FKGK-ja të themelohet sa më shpejt që është e mundur, ashtu që Kosova të mund të përfitojë nga disponueshmëria e këtyre fondeve dhe krijimi i rritjes ekonomike dhe punësimeve të reja.

FKGK-ja do të jetë shumë i dobishëm për bizneset e Kosovës që do të përfitojnë financat dhe të rrisin qarkullimin e tyre. Publiku do të përfitojë përmes rritjes së aktiviteteve ekonomike e sidomos nga disa mijëra vendeve të reja të punës të krijuara. Bankat do të përfitojnë nga të qenit të gatshme që përfundimisht të fusin në përdorim likuiditetin e tyre dhe të zgjerojnë bazën e tyre të klientëve. IMF-të dhe IFJB-të do të përfitojnë nga zvogëlimi i riskut. Kosova përfundimisht do të përfitojë nga rritja e prodhimtarisë lokale, përmirësimi i bilancit tregtar, rritja e punësimit, rritja e tatimeve në të ardhura të korporatave, si dhe rritja e kontributeve pensionale, në harmoni me Strategjitë e NVM-ve dhe ZHSP-së në Kosovë.

**Tabela 3: Objektivat, Aktivitetet dhe Afati Kohor**

<b>Objektiva 1</b>	<b>Aktiviteti 1</b>	<b>Afati Kohor</b>
<b>Ligj për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore</b>	<p>Hartimi i Koncept Dokumentit</p> <p>Hartimi i Projektligjit për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore</p> <p>Miratimi nga Kuvendi i Projektligjit për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore</p>	Maj 2015- Shtator 2015
<b>Objektiva 2</b>	<b>Aktiviteti 2</b>	<b>Afati Kohor</b>
<b>Operacionalizimi i FKGK si një entitet i pavarur juridik</b>	<p>Zgjedhja e Bordit Menaxhues</p> <p>Hartimi i akteve nën-ligjore për implementimin e ligjit</p>	Tetor 2015-Dhjetor 2015

## KAPITULLI 4: OPSIONET

### *Opsioni 1: Opsioni i status-quo (pa ndryshim)*

Lënia e gjendjes aktuale të pandryshuar do të thotë që shumë ndërmarrës me NMVM-të e tyre, bujqit, etj., do të vazhdojnë të përballen me vështirësi të skajshme për të siguruar shumat dhe llojet e financave që iu nevojiten për kapital punues afatshkurtër dhe investime afatgjate.

### *Opsioni 2: Miratimi i ligjit të ri për themelimin e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive si subjekt i pavarur dhe autonom*

FKGK-ja do të themelohej si subjekt i pavarur dhe autonom me ligj, analog me themelimin e Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK). Ligji dhe veprimtaria e FKGK-së do të përshtateshin me funksionin e tij specifik të ofrimit të garancive për kredi.

Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë do të themelojë Fondin për Garanci Kreditorë, si dhe do të përcaktojë autorizimet, strukturën, qeverisjen, operimin, fushëveprimin dhe rregullat dhe procedurat për ofrimin e Garancive Kreditorë. Përveç tjerash, ligji do të rregullojë: Parimet e Garancive Kreditorë dhe Përshtatshmërinë, Detyrimet e FKGK, formën dhe themelimin e tij, përfshirë kompetencat dhe përgjegjësitë, burimet e financimit, financimin dhe instrumentet.

Ligji poashtu do të rregullojë qeverisjen e FKGK, përfshirë kompetencat dhe përgjegjësitë e Bordit Menaxhues dhe Drejtorit Menaxhues si dhe mbikqyrjen nga BQK-ja.

Ligji do të implementohet nga FKGK i mbikqyrur nga BQK-ja. Legjislacioni sekondar do të nxjerret për qëllime të implementimit të këtij ligji.

### *Opsioni 3: Themelimi i FKGK-së si Shoqëri Aksionare (SHA) apo si Organizatë Jo-Qeveritare (OJQ)*

Një opsion tjetër që është trajtuar ka qenë themelimi i FKGK-së si Shoqëri Aksionare private apo si Organizatë Jo-Qeveritare.

## KAPITULLI 5: PËRMBLEDHJE E OPSIONEVE

Përmbledhje e opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Tiparet kryesore të opsionit	Gjendja aktuale mbetet e pandryshuar	FKGK themelohet si subjekt i pavarur juridik dhe autonom me ligj. Ky opsion është i pranueshëm për Bankën Qendrore, institucionet financiare dhe donatorët.	FKGK themelohet si SHA private apo OJQ. Ky opsion është i vështirë të implementohet me Bankën Qendrore, institucionet financiare dhe donatorët.
Popullata/sectorët/ rajonet e synuara që shënjestrohen	N/A	NVM-të dhe popullata e sektorët tjerë më pak të shërbyer	NVM-të dhe popullata e sektorët tjerë më pak të shërbyer
Karakteristikat e implementimit – kush është përgjegjës – qeveria (kush), sektori privat, qytetarët	N/A	Qeveria e Kosovës dhe donatorët, përfshirë USAID-in, KfW-në dhe SECO	Qeveria e Kosovës, donatorët dhe institucionet financiare
Administrimi apo ofrimi i programit apo shërbimit	N/A	N/A	N/A
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshim-plotësimet, zbatimi, sanksionet	Aktualisht nuk ka ligj që rregullon fushën	Ligji për themelimin e FKGK-së	Nuk nevojitet ligj

Fushata edukuese e komunikuese	N/A	Fushatat komunikuese për të informuar përfituesit e FKGK-së duhen konsideruar pas themelimit të tij.	N/A
Udhëzime e kode	N/A	N/A	N/A
Afatet kohore – kur cili opion mund të hyjë në funksion	N/A	Fundi i vitit 2015	N/A

## KAPITULLI 6: ANALIZA E OPSIONEVE

### *Dobitë:*

**Opsioni 1:** Nuk ka ndonjë dobi të parashikueshme.

**Opsioni 2:** FKGK-ja themelohet si subjekt i pavarur me ligj, si dhe do të lehtësojë në masë të madhe huadhënien e institucioneve financiare për bizneset lokale, duke iu ndihmuar të tejkalojnë këtë pengesë. Rritja e huadhënies nga institucionet financiare drejtpërdrejt çon tek rritja e qarkullimit, rritja e punësimit, rritja e eksporteve, e përfundimisht edhe tek zgjerimi i prodhimitarisë vendore të produkteve cilësore e konkurruese, si dhe rritja e të ardhurave nga tatimet në të hyra e pensione. Veçanërisht, projektohet që FKGK-ja të arrijë të përkrahë mbi 4,150 kredi të reja për NMVM-të me vlerë kumulative prej mbi 360 milionë Eurosh, duke krijuar kështu mbi 20,000 vende të reja pune në 6 vitet e para të funksionimit të tij. Qasja me subjekt të pavarur e autonom tejkalon të gjitha pengesat e identifikuar në rrugën e krijimit të një Fondi të tillë të suksesshëm, i cili do të ishte i pranueshëm për BQK-në, QRK-në dhe bankat komerciale. Subjekti i pavarur dhe autonom mundëson pavarësinë, transparencën dhe shmangien e konflikteve të interesit. Ai përmbush kriteret e qeverisë dhe donatorëve për sigurimin e fondeve të tyre. Institucionet financiare do të kenë kontrata të barabarta me FKGK-në, ngjashëm me rregullimet e institucionet

financiare për Garancitë për Hua AZHK në USAID. FKGK-ja si entitet i pavarur juridik dhe autonom do të themelohet dhe të veprojë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe do të jetë fond i përhershëm, lokal, i qëndrueshëm, që përkrah rritjen e qasjes në financa për bizneset e Kosovës. FKGK do të gëzojë kredibilitetin e nevojshëm tek institucionet financiare dhe BQK-në në lëshimin e garancive të tij.

Themelimi i FKGK-së gjithashtu do të ketë ndikime të mëdha fiskale. Vlerësohet që huatë e rritura do të krijojnë qarkullim të ri inkremental prej 1 miliardë eurosh në gjashtë vitet e para të veprimtarisë. Pjesa më e madhe e këtij qarkullimi do të vijë nga prodhimtaria vendore, duke përmirësuar kështu edhe bilancin tregtar. Këto shitje apo qarkullim do të mund të rezultojnë në rreth 10 milionë euro në të ardhura nga tatimet në të hyra të korporatave. Vendet e reja të punës do të mund të krijonin rreth 12 milionë euro në kontribute pensionale.

Nga FKGK do të përfitojnë llojet e bizneseve si në vijim:

- Bizneset e reja me më pak se 3 vite
- Fermerët dhe NMVM që merren me procesim ushqimi
- NMVM-të pa shuma të mëdha të aseteve fikse për kolateral (shumica e NMVM-ve)
- Bizneset në pronësi të grave
- Bizneset në pronësi të minoriteteve
- Bizneset në Veriun e Kosovës
- Bizneset me produkte dhe shërbime të reja dhe inovative
- Bizneset urbane dhe rurale
- NMVM-të që duan të rrisin prodhimin vendor për zëvendësimin e importit dhe për eksport
- Bizneset që implementojnë programe për energji të ripërtrishme dhe eficiencë të energjisë
- Bizneset TIK
- Bizneset e teknologjisë



**Opsioni 3:** FKGK-ja mund të themelohet pa nevojën e miratimit të një ligji të ri, që ka dobinë e shpejtësisë, por nuk është realisht opsion i mundshëm, për shkak të pasojave negative siç përshkruhen në vijim.

***Pasojat negative:***

**Opsioni 1:** Mosveprimi do të çojë në humbjen e qindra miliona eurove në kredi, mijëra vendeve të punës, miliona euro në eksporte e miliona euro në tatime mbi të hyra dhe kontribute pensionale, që do të arriheshin nëse implementohet FKGK-ja. Themelimi i FKGK-së do të krijojë qarkullim e shitje, vende pune, eksporte, tatime në të hyra, si dhe kontribute pensionale, kështu që mund të konsiderohet që nëse nuk ndërmerren veprime të tilla në fakt do t'i kushtojnë Buxhetit të Kosovës shumë miliona euro të ardhura të humbura, të cilat do të realizoheshin po të themelohej FKGK-ja.

**Opsioni 2:** Sipas informatave në dispozicion dhe konsultimeve me palët e përfshira, nuk ka ndonjë pasojë të dukshme negative të miratimit të ligjit të ri për FKGK-në.

**Opsioni 3:** Implementimi i një shoqërie aksionare private (SHA) është vërtetuar të jetë problematik, për shkak se as bankat e as BQK-ja nuk duan të jenë aksionarë, si dhe do të ishte e vështirë edhe për donatorët edhe qeverinë që të ofrojnë kapitalin për mbështetjen e garancive për një kompani private.

Struktura e OJQ-së është shumë e padëshirueshme për BQK-në për institucione financiare. Për më tepër, struktura e OJQ-së do të kishte shumë më pak kredibilitet tek institucionet financiare.

***Kostoja:***

Opsioni i mundshëm për të proceduar është opsioni 2, themelimi i FKGK-së si subjekt i pavarur dhe autonom juridik. Siç është përshkruar më lart, nuk pritet ndonjë kërkesë shtesë nga Buxheti i Kosovës, përtej fondeve kapitale tashmë të ndara që do të kontribuohen nga QRK-ja. QRK-ja dhe donatorët do të ofrojnë kapitalin për të mbështetur garancitë. Zhvillimi, asistenca teknike, trajnimet dhe shpenzimet fillestare operative po mbulohen nga Projekti i USAID-it EMPOWER për Përkrahjen

Kreditore. Shpenzimet e mëtutjeshme operacionale do të mbulohen nga vetë FKGK-ja.

Fondet që sigurohen nga donatorët janë në dispozicion për një afat të kufizuar, si dhe janë zotuar për një mekanizëm garancish. Është kritike që FKGK-ja të themelohet këtë vit ashtu që Kosova të përfitojë nga fondet e donatorëve, gjë që kërkon që ligji të hartohet e të shpallet sa më shpejt që është e mundur.

**Tabela 5: Kostoja**

Kategoria e Shpenzimeve	Buxheti për 2015	Buxheti për 2016	KASH për 2017
<b>Buxheti i MTI</b>			
- Paga dhe Mëditje	0.00	0.00	0.00
- Shpenzime Materiale	0.00	0.00	0.00
- Subvencione dhe Transfere	1,000,000.00	0.00	0.00
- Shpenzimet Kapitale	0.00	0.00	0.00
<b>Buxhet tjetër</b>	0.00	0.00	0.00
<b>Financime nga Donatorët-USAID</b>	6,500,000.00	0.00	0.00
<b>Financime nga Donatorët-KfW</b>	0.00	2,000,000.00	0.00
<b>Financime nga Donatorët-ADA</b>	0.00	1,000,000.00	0.00
<b>Financime nga Donatorët-SECO</b>	0.00	1,000,000.00	0.00
<b>Shpenzime Direkte nga MF</b>	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>7,500,000.00</b>	<b>4,000,000.00</b>	<b>0.00</b>

## KAPITULLI 7: KONSULTIMET

Qeveria e Kosovës, përkrahur nga Projekti i USAID-it EMPOWER për Fuqizim të Mbështetjes Kreditore, ka konsultuar faktorë relevantë vendorë e ndërkombëtarë, si pjesë e procesit të identifikimit dhe formulimit të politikave. Palët kryesore që janë konsultuar janë bankat komerciale të Kosovës, organizatat donatore ndërkombëtare, Banka Qendrore e Kosovës, si dhe ministritë e agjencitë e Qeverisë së Kosovës, si janë Zyra e Presidentes, Zyra e Kryeministrit, Zyra e Kryetarit të Kuvendit, Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integriteteve Evropiane, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Zyrën e Avokatit të Popullit. Poashtu janë

konsultuar institucione të ndryshme nga shoqëria civile sic është Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSCE), UNHCR, GIZ, Indep dhe Civikos.

Janë mbajtur edhe konsultime me një numër ekspertësh vendorë e ndërkombëtarë. Konsultime të mëtutjeshme do të bëhen në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës, pasi të ketë filluar procesi formal i hartimit të ligjit.

Shumica e rekomandimeve të marra nga institucionet e lartpërmendura gjatë procesit të konsultimeve janë përfshirë në këtë koncept dokument.

## **KAPITULLI 8: KRAHASIMI I OPSIONEVE**

Nga të tre opsionet e identifikuar:

*Opsioni 1* nuk rekomandohet pasi që mund të merret parasysh që mosveprimi do të rezultojë në humbjen e qindra miliona eurove në kredi, mijëra vendeve të punës, miliona eurove në eksporte, si dhe miliona eurove në tatime në të hyra e kontribute pensionale që do të arriheshin po të zhvillohej FKGK-ja.

*Opsioni 2* është opsioni i preferuar, sepse themelimi i FKGK-së si subjekt i pavarur dhe autonom me ligj do të lehtësonte në masë të madhe rritjen e kreditimit nga institucionet financiare për bizneset vendore. Për më tepër, rritja e kreditimit nga institucionet financiare do të çojë drejt rritjes së shitjeve, rritjes së punësimit, eksporteve, e zgjerimit të prodhimit vendor të produkteve cilësore e konkurruese, e përfundimisht edhe tek rritja e tatimeve në të ardhura dhe të ardhura pensionale.

*Opsioni 3* nuk është opsioni i preferuar, për arsyet e përshkruara në analizën e opsioneve.

## **KAPITULLI 9: ARSYETIMI I PROPOZIMIT**

Mijëra biznese në Kosovë nuk arrijnë të sigurojnë financimin që iu duhet për t'u rritur, për të rritur shitjet, për t'u bërë më konkurrues, për të krijuar vende pune, për të eksportuar, apo për të zgjeruar prodhimtarinë vendore. Kjo është pengesë kritike ndaj rritjes ekonomike dhe punësimit në Kosovë, e cila duhet tejkaluar urgjentisht. FKGK-

ja do të lehtësojë në masë të madhe rritjen e kreditimit nga institucionet financiare për bizneset vendore, duke ndihmuar kështu në tejkalimin e kësaj pengese. Rritja e kreditimit nga institucionet financiare do të çojë drejt rritjes së shitjeve, rritjes së punësimit, eksporteve, e zgjerimit të prodhimit vendor të produkteve cilësore e konkurruese, e përfundimisht edhe tek rritja e tatimeve në të ardhura dhe të ardhura pensionale. Veçanërisht, projektohet që FKGK-ja do të arrijë të mbështesë mbi 4,150 kredi të reja për NMVM-të me vlerë kumulative mbi 360 milionë euro, duke krijuar kështu mbi 20,000 vende të reja të punës në 6 vitet e para të funksionimit të tij.

QRK-ja si dhe donatorët ndërkombëtarë, si USAID, KfW dhe SECO janë zotuar tashmë për mbi 20 milionë dollarë/18 milionë euro në ndihmë teknike në zhvillimin dhe zbatimin e FKGK-së dhe kapitalit për dhënien e garancive. Është me rëndësi që FKGK-ja të themelohet sa më shpejt që është e mundur, ashtu që Kosova të mund të përfitojë nga disponueshmëria e këtyre fondeve, të cilat mund të humben nëse FKGK-ja nuk themelohet që këtë vit.

FKGK-ja do të jetë shumë i dobishëm për bizneset e Kosovës që do të përfitojnë financat dhe të rrisin qarkullimin e tyre. Publiku do të përfitojë përmes rritjes së aktiviteteve ekonomike e sidomos nga disa mijëra vendeve të reja të punës të krijuara. Bankat do të përfitojnë nga të qenit të gatshme që përfundimisht të fusin në përdorim likuiditetin e tyre dhe të zgjerojnë bazën e tyre të klientëve. IMF-të dhe IFJB-të do të përfitojnë nga zvogëlimi i riskut. Kosova përfundimisht do të përfitojë nga rritja e prodhimtarisë lokale, përmirësimi i bilancit tregtar, rritja e punësimit, rritja e tatimeve në të ardhura të korporatave, si dhe rritja e kontributeve pensionale, në harmoni me Strategjitë e NVM-ve dhe ZHSP-së në Kosovë.

## **KAPITULLI 10: REKOMANDIMI**

Pas shqyrtimit të tre opsioneve për zgjidhjen e kësaj çështjeje, ne rekomandojmë që Qeveria të miratojë këtë koncept-dokument dhe të zgjedhë Opsionin 2 (miratimi i një ligji të veçantë që themelon FKGK-në si subjekt i pavarur dhe autonom juridik) si opsioni më i arritshëm për të arritur synimet e përshkruara me këtë koncept-dokument.

Në gjashtë vitet e para të operimit të plotë, FKGK do të mbështesë 4,150 kredi të reja për NMVM-të në shumë prej 360 milion Euro, duke krijuar 20,000 vende pune. Këto të dhëna janë nxjerrë në konsultim me bankat komerciale, bazuar në analizën e nevojave financiare të NMVM, disavantazhet tjera dhe projeksionet e detajuara financiare për gjashtë vite për FKGK. Shuma mesatare e kredisë do të ishte rreth 87,000 Euro gjë që është e përshtatshme për NMVM-të. Numri i kredive është konservativ lidhur me atë se cka bankat mund të disbursojnë për periudhë gjashtë vjecare. Numri i vendeve të punës është bazuar në krijimin e vendit direkt të punës për cdo 18,000 Euro të kredituara. Përvoja tregon që kur financohet një NMVM për rritje, shumë vende pune krijohen, dhe 18,000 Euro kreditim për një vend pune është numër i arsyeshëm dhe konservativ bazuar në përvojat globale. Ashtu sic u përmend më lartë, ndërmjetësimi financiar në Kosovë është ndër më të ulëtit në botë dhe ka mundësi të mëdha në rritje për të ngritur numrin dhe vlerën e kredive dhe rrjedhimisht edhe të prodhimit vendor, eksportit dhe vendeve të punës.

Kjo do të sigurojë që FKGK-ja të themelohet si subjekt i pavarur dhe autonom me ligj, analog me themelimin e Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK). Ligji dhe operimi i FKGK-së do t'i përshtaten funksionit specifik të ofrimit të garancive për kredi.

FKGK-ja do të ketë autonomi operative dhe administrative. Ai do të ketë rregullore të brendshme, politika, procedura e sisteme kontrolli rigorozë për qeverisjen korporative, mbikëqyrje, menaxhim, operacione, resurse njerëzore, financa, kontabilitet, auditim, monitorim, raportim e prokurim. FKGK-ja do të ketë një bord të pavarur drejtorësh si dhe do të ketë kontrata me institucionet financiare për ofrimin e garancive për kredi.

Draft ligji do të themelojë dhe përcaktojë strukturën e FKGK, duke përfshirë qeverisjen e tij, raportimin dhe financimin. FKGK do të ketë një Bord Menaxhues dhe Drejtorin Menaxhues. Në ligj do të përfshihen kriteret bazë që duhen plotësuar për anëtarët e bordit dhe drejtorin menaxhues, parandalimin e konfliktit të interesit si dhe procedurat dhe rregullat e brendshme të FKGK.

Garancitë e kredive që sigurohen nga FKGK-ja për institucionet financiare do të rregullohen me rregulloret e BQK-së, kontratat ndërmjet FKGK-së dhe institucionet financiare, si dhe rregulloret e brendshme, politikat e procedurat e FKGK-së.

Anëtarët e bordit të pavarur të drejtorëve do të përmbushin kriteret e kualifikimit sipas këtij ligji, por edhe kërkesave të përshtatshmërisë për anëtarë të bordeve sipas të gjitha ligjeve e rregulloreve në fuqi. Anëtarët e bordit menaxhues do të kenë nivel të lartë përvojë, ekspertizë, profesionalizmi, etike e pavarësie, si dhe do të zgjidhen përmes një procesi të drejtë, meritator dhe transparent të rekrutimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës si dhe organizatat donatore ndërkombëtare do të sigurojnë kapitalin fillestar për mbështetjen e garancive. Përveç këtyre, USAID-i do të ofrojë ndihmën teknike dhe fondet fillestare operationale për themelimin dhe lansimin e FKGK-së. FKGK-ja pastaj do të bëhet financiarisht i vetë-qëndrueshëm.